



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në një rrëzë anë;

Dhe

KONTRAKTORI "ALFA-I" Komuna e Istogut, të cilën e përfaqëson z. Shkodran Jahaj, me Nr. Unik i Rexh. Biznesi, 810298853 (në vazhdim "Kontraktuesit"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

TRASIMI I RRUGËS RURALE DHE KANALIT TË UJITJES NË MUZHEVINË

<i>Nr. I prokurimit</i>	<i>633-20-4978 / 5-2-1/ C382 LOT 3</i>
<i>Nr. I brendshëm</i>	<i>633 / 020 / 069 / 521</i>

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

TRASIMI I RRUGËS RURALE DHE KANALIT TË UJITJES NE MUZHEVINË

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi i punëve për aktivitetin e prokurimit: TRASIMI I RRUGËS RURALE DHE KANALIT TË UJITJES NE MUZHEVIN është: 28.556,38 dhe me fjalë: /Njëzetetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro 38 /100 €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet
Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Afati i përmbushjes së kontratës:

4.1. Të gjitha punimet sipas kësajë kontrate do të përfundojnë me datë, 15.11.2020

Neni 5 Ndërprerja e kontratës:

5.1 Kjo kontratë mund të shkëputet kurdo që kontraktori nuk i respekton kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës të parapara në dosjen e tenderit, dhe kur për një gje të tillë plotësohen këto kushte.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin

titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.





6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për: Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për: Kontraktuesin:
"Alfa – I" Shpk

Emri:	Gëzim Ademaj	Emri:	Shkodran Jahaj
Pozita:	U.D. Menaxher-it të Prokurimit	Pozita:	M e n a x h e r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	16. 10. 2020	Data:	16/10/2020
Vu la		Vu la	

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së përgjithshme të kontratës 10% e vlerës së kontratës, me vlefshmeri 30 dite me gjate perfundimi i kontratës.</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do të jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe të gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do të jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimit</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>1muaj</i>
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>i caktuar me vendim të ZKA</i>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <i>5DITE</i> pas nënshkrimit të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do të provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do të organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do të jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë

PARAMASA DHE PARALLOGARIJA

"Ndertimi i Rrugës Fushore dhe Kanalit për ujitje në Fshatin Muzhevinë"

$L=S_1+S_2+S_3=600+233+395.34=2,110.00$ m. $L=1,228.34$ m.

$S1=600$ m. Nga P1-P25 ; $S2=233.00$ m. Nga P25-P35; $S3= 395.34$ m. nga P1-P17

Nr.	POZICIONET	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	PUNËT PARAPRAKE				
1.1	Shenimi i trasesë para fillimit të punimeve si dhe punimi i situacionit dhe profileve tërthore .	m'	1,228.34	0.20	245.67
1.2	Prerja e shkurreve dhe e drunjëve me shkulle të rrënjëve dhe bartje të materialit deri në deponi , 5 km. (deri në deponi do të barten vetem rrënjët,shkurret dhe drujt do ti marrin qytetarët, dheu i mihur te shfrytëzohet për mbushje).	m'	1,228.34	1.00	1,228.34
PUNËT PARAPRAKE			Gjithsej:		1,474.01
2	PUNIMET E DHEUT				
2.1	Mihja e dheut,Planifikimi i dheut të kategoris III ,bartja mbrenda trase sipas nevoje për mbushje.	m³	1,408.34	1.90	2,675.85
2.2	Punimi i mbushjes me shtrirje dhe ngjeshje me material guror në shtresa t=30 cm.Shtresa stabilizuese material CBR>5%.	m³	3,462.51	2.00	6,925.02
2.3	Furnizmi me material dhe punimi i shtresës së tamponit nga guri gëlqeror , fraksion 0-63mm me trashësi t=25cm në gjendje të ngjeshur .Msh≥80MN/m²	m³	1,011.26	3.00	3,033.77
PUNIMET E DHEUT			Gjithsej:		12,634.63
3	OBJKTET				
3.1	Punimi i lëshesës gypore me: Furnizim,bartje dhe montim i gypave të armuar nga betoni C-20/25 të vendosur në shtresë tamponi.Punimi i kokave të lëshesave me C-20/25 .				
	Ø600mm	m'	42.00	33.00	1,386.00
3.2	Punimi i kanalit për ujitje Betonarme në formë trapezi sipas prerjes tërthore të prezentuar në profilet karakteristike.Armimi te behet me armatur rretë.Prerja terthore e kanalit a=50cm,b=60cm,t=15cm. Kanali dhe Rruga duhet të jenë 20 cm. mbi koten e terrenit.	m'	600.00	10.00	6,000.00
3.3	Punimi i kanalit për ujitje Betonarme në formë trapezi sipas prerjes tërthore të prezentuar në profilet karakteristike.Armimi te behet me armatur rretë.Prerja terthore e kanalit , a=40cm,b=50 cm,t=15cm. Kanali dhe Rruga duhet të jenë 20 cm. mbi koten e terrenit.	m'	628.34	11.00	6,911.74
3.4	Punimi dhe vendosja e presave nga materiali i qelikut,se bashku me shinat e saj,sipas detajit te dhene nga organi mbikqyrës.	copa	6.00	25.00	150.00
OBJKTET			Gjithsej:		14,447.74
			PUNËT PARAPRAKE		1,474.01
			PUNIMET E DHEUT		12,634.63
			OBJKTET		14,447.74
			TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT		28,556.38

